



Kom.Dh.Shk.II.nr.800/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Krenar Berisha, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit shoqëria tregtare N.P.T “P...” biznes individual, me seli ne Ferizaj, e përfaqësuar me autorizim nga A.S, avokate në Prishtinë, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli ne Prishtinë, rr.”Ukshin Hoti” – kompleksi Ramiz Sadiku, e qe sipas autorizimit përfaqësohet nga Ministria e Drejtësisë – Avokatura Shtetërore me seli ne Prishtine, në çështjen juridike kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala paditëse përmes te autorizuarës se saj, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.406/15, të dt.06.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa paditëses NPT “P...” biznes individual, me seli ne Ferizaj, ashtu që **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.406/15, të dt.06.09.2021, dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje, Gjykatës Komerciale, Dhomës se Shkallës se Parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor EK.nr.406/15 te datës 06.09.2021, ka vendosur me sa vijon:

I.Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike.

II.Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda t’i dërgohet Departamentit të Përgjithshëm – Divizionit Civil, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si Departament me kompetencë lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese.

Kundër këtij aktvendimi, paditësja ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi ankimor të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe nenin 195 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja N.P.T “P...”, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 18.09.2015, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, për kompensim dëmi. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të kësaj çështje juridike, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit ankimor duke u bazuar në nenin 16.1.1 të Ligjit për Gjykata dhe neni 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë qëndron te jetë i themeltë pretendimi ankimor i paditëses NPT “P...”, për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejtë dhe konform nenit 19 të LPK-së, kur është shpallur jo kompetente ne pikëpamje lëndore për te vendosur ne këtë çështje juridike, e duke u thirrur se këtu e paditura nuk është shoqëri tregtare. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktvendimit te atakuar ne kuptim te nenit 13 par.1 nën par.1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale ku shprehimisht përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për te gjykuar “kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe te huaja si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, ne lidhje me çështje te ndërsjella tregtare dhe çështje tjera ne mes tyre” .

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur ka vendosur se nuk është kompetente për te vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe neni 209 pika b) të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.800/2022, me datë 01.09.2022**

Gjyqtari,

Faton Bajrami, d.v.